

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	NATO përgatitet për skenarin ekstrem, qeveria italiane i druhet përshkallëzimit të konfliktit nga Moska: S ulm i mundshëm në fillim të 2027-ës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/nato-pergatitet-per-skenarin-ekstrem-qeveria-italiane-i-druhet-pershkallesi-i586778
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:43:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 21:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9819bc3d333cd86f4b953a95a9449ce4813079b5752dfadb51b8811636a6908d
TEKSTI	10e74ca2ffb4963d572934c21a227cef688426daebdae11c6259d32f8948d159
PAMJA	564f60131fbd7ccd360c7421a32da6a67237505557e7c5f6de88534e024f58cf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9b0e0e11558c2a4d8b535ee47441e5c2ee2d99f097fa771dc8e7d4e2a02ed704
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9b0e0e11558c2a4d8b535ee47441e5c2ee2d99f097fa771dc8e7d4e2a02ed704>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e "Syte" ruse mbi Ameriken, 14 satelite spiune mbi bazen e SHBA para sulmit IranianErdoğan per anetaresimin e Turqise ne BE: Nuk eshte me prioriteti yne, ata do te hum fundit

NATO përgatitet për skenarin ekstrem, qeveria italiane i druhet përshkallëzimit të konfliktit nga Moska: Sulm i mundshëm në fillim të 2027-ës



17 Shtator 2026, 23:10Bota TEMA



Akti i fundit i asaj lufte hibride që në Palazzo Chigi e cilësojnë si të përditshme është dekreti i qeverisë ruse, i publikuar në fillim të shtatorit, i cili në fakt shpronëson degën lokale të kompanisë italiane Dkc. Në Itali, lajmi kaloi pa shumë vëmendje dhe u raportua vetëm nga disa faqe financiare të dorës së dytë. Por në zyrat e qeverisë italiane, veprimin e Kremlinit e cilësojnë si "një sulm ndaj interesave tona ekonomike kombëtare", një lloj rasti i dytë Ariston. Kompania italiane, e cila prodhon materiale elektrike, ka 4.200 punonjës në territorin rus, të cilët prej disa ditësh punojnë nën një administrim me komisar, që ua ka kaluar të gjitha kompetencat personave pranë qeverisë së Moskës.

Nuk janë vetëm dronët, Lituania apo incidentet në kufi. Në Palazzo Chigi mbajnë një bilanc të përditshëm dhe javor të veprimeve që i cilësojnë si armiqësore, hakmarrëse apo spiunazhi, dhe jo të gjitha ato që bllokohen bëhen publike. Sipas tyre, pas këtyre veprimeve do të qëndronin entitete fizike ose digjitale që vijnë nga Rusia.

"Arritën të spiunonin madje edhe disa drejtues të kompanive tona me pjesëmarrje shtetërore dhe, për fat, në atë rast ndërhyrë në kohë", tregon një person që ndjek një dosje ku ndërthuren gjeopolitika, shërbimet e inteligjencës dhe zyrat diplomatike.

Por nëse droni me origjinë ruse, i goditur nga një avion luftarak italian në kufirin baltik të Aleancës Atlantike, 13 orë përpara se ministri italian i Mbrojtjes, Guido Crosetto, të mbërrinte për vizitë, është vetëm një nga episodet e shumta që mbahen shënim në Palazzo Chigi, dhe madje jo ndër më të spikaturit, pasi lidhja me interesat italiane dhe përfshirja e avionit italian ishin vetëm rastësi, makthi i vërtetë, skenari ekstrem për të cilin flitet me zë të ulët në Romë dhe që në selinë e NATO-s në Bruksel është objekt analizash të thelluara prej të paktën dy muajsh, është ai i një sfide të hapur nga Putin.

Për ushtarakë, diplomatë dhe jo pak zyrtarë të disa kancelarive, ky është njëkohësisht një alarm, një rebus dhe një lëvizje e mundshme shahu që askush nuk do të donte ta pësonte: një sulm kirurgjikal ndaj interesave dhe objektivave jetike të NATO-s, ndoshta në një prej vendeve më të lehta për t'u goditur. Rumania është në krye të simulimeve që bëhen në Bruksel, ndërsa një sulm mund të vinte si nga Deti i Zi, ashtu edhe përmes rajoneve të Transnistriës. Synimi do të ishte testimi i aftësive dhe vullnetit real të Aleancës për t'u përgjigjur.

Amerikanët kanë qenë të parët që kanë formuluar këtë skenar, duke qenë se zinxhiri i komandës së NATO-s mbështetet tek inteligjenca dhe sistemet e tyre informatike, por tashmë dosja është ndarë gjerësisht me shumë prej vendeve europiane anëtare të organizatës ushtarake.

Për Kremlinin, kjo do të ishte një mënyrë për të verifikuar nëse neni 5 i Traktatit të NATO-s i qëndron provës së fakteve. Natyrisht, do të ishte jo vetëm një rrezik i madh, por edhe një shkak i mundshëm për një përshkallëzim të vështirë për t'u ndalur. Një sulm i qartë në territorin e NATO-s vështirë se mund të mos shkaktonte një reagim dhe aktivizimin e ndihmës së ndërsjellë të parashikuar nga klauzola e nenit 5.

Në raportet që shpërndahen nga Brukseli dhe që kanë mbërritur edhe në zyrat ku punon Giorgia Meloni, skenari, ndoshta në muajt e parë të vitit 2027, tashmë konsiderohet “i mundshëm”. Nuk është më vetëm një hipotezë, por është objekt i kundërmasave që janë në fuqi që prej fillimit të verës. Sipas shkrimit, kjo është shenjë se lufta hibride në vazhdim ka kaluar tashmë çdo nivel të imagjinueshëm.

Dhe është pikërisht në këtë klimë që Giorgia Meloni mbërrin pasditen e sotme në Norvegji, për një takim dypalësh dhe një darkë me qeverinë vendase, me orientim socialist. Një takim që mund të duket i zakonshëm, por që në dosjet që po përgatiten nga të dyja palët përfshin dy kompanitë kryesore italiane të sektorit ushtarak, Leonardo dhe Fincantieri, për një gamë bashkëpunimesh të mundshme industriale me kompanitë homologe norvegjeze, që cilësohet pothuajse “e pafundme”.

Nuk përjashtohet as një diskutim për naftën dhe gazin, duke pasur parasysh kapacitetet e mëdha prodhuese të industrisë norvegjeze, furnizuesja kryesore e Bashkimit Europian me gaz të lëngshëm. Edhe për këtë arsye raportohet prania e përfaqësuesve të Eni-t në delegacionin italian./CorrieredellaSera

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"Sytë" rusë mbi Amerikën, 14 satelitë spiunë mbi bazën e SHBA para sulmit iranian

22:40 Bota

Erdogan për anëtarësimin e Turqisë në BE: Nuk është më prioriteti ynë, ata do të humbasin, jo ne

22:30 Bota

Pesë të vrarë nga 'lufta me dronë' mes Arabisë Saudite dhe rebelëve Houthi

22:10 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.